



RÖFIX Putzgrund UNI

Astar forcues

Udhëzime teknike dhe ligjore:

Gjatë aplikimit të produkteve tona, respektoni të dhënat në skedat teknike, të cilat janë në përputhje me standardet e përgjithshme dhe specifike të vendit, si dhe të merren parasysh rekomandimet e shoqatës kombëtare të specialistëve.

Fushat e përdorimit:

Astar i gatshëm për përdorim, i pigmentuar me materiale mbushës mineral.
Astar universal për njëtrajtësimin e aftësive thithëse dhe hidrofobimin e bazamenteve me aftësi të lartë thithëse në ambiente të jashtme.
Për shtresën përfundimtare mund të përdorni grafiatot pastoze shtresë hollë si psh. SISI-,rezinë Silikoni-, Silikati- ose me dispersion /rezinë akrilike).
Astari e përgatit bazamentin në mënyrë të atillë sa është ideal për aplikimin e grafiatove pastoze.
Astari përmirëson përthithjen e ujit (reth 30%), nivelimin dhe aftësinë thithëse. Reagimi me suvanë ndikon në përmirësimin e karakteristikave të suvave minerale.
Aplikimi i suvasë mbi bazamente të lagura, ose pa astar ose mbi astar të pa tharë mirë, mund të shkatërrojë komplet shtresën e hollë të krijuar, që ditën e parë (reduktim i algave- dhe kërpudhave).
I papërshtatshëm për stuko allçije dhe bazamente me përmbajtje allçije.

Karakteristikat:

- Aftësi të larta ngjitëse
- Thithja e ujit nga bazamenti, paksohet në mënyrë të dukshme
- Nuk përmban mjete humbëse
- Neutralizon vleren pH.

Përpunimi:



Të dhëna teknike		
SAP-Art. Nr.:	2000150766	2000150767
NAV-Art. Nr.:	117573	117574
Lloji i paketimit		
Njesi per palete	24 Nj./Pal	64 Nj./Pal
Sasi për njësi	20 kg/Nj.	5 kg/Nj.
Ngjyra	E bardhë	
Konsumi	ca. 0,23 kg/m ²	
Konsumi i ujit	ca. 90 m ² /Nj.	ca. 22,5 m ² /Nj.
Vlera e pH	ca. 8,5	
Këshilla për paketimin	Në kova plastike të riciklueshme	
Temperatura e bazamentit	> 5 - < 25 °C	

Baza e materialit:

- Mjete lidhëse me dispersion
- Material mbushës (mineral)
- Pigmente boje

Kushtet e punimit:

Gjatë fazës së tharjes dhe përpunimit, temperatura e ambientit dhe bazamentit nuk duhet të bjerë nën +5 °C.
Deri sa të arrihet tharja e plotë, mbrojeni nga ngrirja, tharja e shpejtë (rezatimi direkt i diellit, era) dhe shiu.
Lagështia e ambientit nuk duhet të kalojë 65 % lagështi e mbetur gjatë fazes së aplikimit dhe tharjes.

Bazamenti:

Bazamenti duhet të jetë i thatë dhe i pastër, me aftësi mbajtëse si dhe pa papastërti si p.sh. pluhur, alga, blozë, kripra etj. .

Bazamenti-Trajtimi paraprak:

Ju lutem kini parasysh edhe „Rregulloret e përpunimit të suvavë të sipërme“ të Shoqates Austriake Profesionale te Suvase



RÖFIX Putzgrund UNI

Astar forcues

Përgatitja:	Produkt i gatëshëm për përdorim Mos e holloni
Përpunimi:	Shtrimi vijon i plotë, i njëtrajtshëm, duke mbuluar gjithshka, me anë të një furce, apo rruli.
Këshilla:	Pjesët kufizuese të ndërtesës (si dyer, dritare korniza dritaresh etj) përgjithësisht duhet të mbulohen para punimeve për të mënjeluar ndotjen ose korrozionin.
Këshilla në rast rezi:	Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda.
Këshilla për përpunimin:	Koha e tharjes para shtrimit të shtresës përfundimtare, min 12 orë (në varësi të temperaturës dhe kushteve atmosferike). Temperaturat e ulëta sikurse lagështia e madhe zgjasin kohën e tharjes. Nëse një lyerje baze është e nevojshme për shkak të nuancës së ngjyrës, kjo duhet të përkohet me ngjyrën e bojës që do të aplikohet dhe për këtë arsye të devijojë nga suvaja e sipërme e mëposhme. Gjatë përdorimit të suvave me ngjyrë, lyerja bazë aplikohet në një nuacë më të errët se ajo e suvasë. Kthimi i materjaleve është i pamundur. Lagështia e ambientit nuk duhet të kalojë 65 % lagështi e mbetur gjatë fazes së aplikimit dhe tharjes.
Magazini:	Magazinojini në vende të freskëta, të mbrojtur nga ngrica dhe të mbyllura mirë. Koha e magazinimit min. 12 muaj.



RÖFIX Putzgrund UNI

Astar forcues

Këshilla të përgjithshme:

Kjo skedë teknike anullon dhe zëvendëson të gjitha versionet e mëparshme.

Të dhënat e këtyre udhëzuesve teknike përkojnë me njohuritë dhe përvojën tonë praktike të deritanishme.

Ky informacion dhe të dhënat janë përpiluar me kujdes dhe me ndërgjegje të plotë, por pa mbajtur përgjegjësi për vendime ose veprime plotësuese që mund të marrë vetë konsumatori. Të dhënat në veteve nuk provojnë asnjë lidhje ligjore ose detyrime të tjera anësore, dhe normalisht nuk e ndalojnë konsumatorin të testojë produktin për ato qëllime për të cilat edhe është prodhuar.

Tek finot pastoze forca në shtypje duhet të jetë minimumi 1,5 N/mm². Mos e përdorni në bazamente të lagështa dhe jo mbi sipërfaqe që janë në kontakt të shpeshtë me ujë. Nuk mund të thuhet se mund të kemi një tharje të bazamentit dhe pa njolla për shkak të kushteve të objektit dhe motit. Për shkak të përdorimit të lëndëve të para natyrore ndryshime të vogla të ndryshimit të ngjyrës janë të mundshme. Objektet që janë të lidhur me njëri tjetrin duhet të lyhen nga i njëjti furnizim/ porosi që të shmangim diferencat në ngjyrë. Në rast se do punohet me të njëjtën ngjyrë për një kohë të gjatë në kantier duhet ti jepet prodhuesit data e porosisë së parë. Materialet e magazinuara mund të shkaktojnë ndryshim ngjyre. Ju lutem përpara aplikimit kontrolloni ngjyrën. Ankesat e mëvonshme nuk mund të merren parasysh.

Agjentët atmosferikë, rrezet UV, ekspozimi nga lagështia ndryshojnë sipërfaqen me kalimin e kohës. Ndryshime të dukshme të ngjyrës janë të mundshme. Ky proces ndryshimi ndikohet nga materiali dhe kushtet e objektit.

Kur fasada nuk është tharë ende, vesa, shiu mund të depozitohen në sipërfaqe. Efekti është i ndryshëm në varësi të intensitetit të ngjyrës i cili ndryshon. Dhe nuk ka ndikim në cilësinë e produktit. Efektet zhduken nga erozioni.

Produktet RÖFIX si dhe të gjitha materialet përbërëse, i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm, me anë të të cilit garantohet një cilësi e pandryshueshme.

Stafi ynë është i gatshëm tju japë cdo ndihmë teknike në lidhje me përdorimin, përpunimin si dhe mund të ofrojë edhe trajnime praktike në lidhje me përdorimin e produkteve tona.

Vlerat teknike janë bazuar tek produktet bazë. Gjatë pigmentimit ose ngjyrosjes, janë të mundshme edhe devijime nga të dhënat teknike. Në dhënien e vlerave bëhet fjalë për vlera mesatare. Meqënëse produktet tona përbëhen nga materiale natyrore, mund të ndodhë që në një ngarkesë të kemi edhe devijime minimale të vlerave. Për veshjen e sipërfaqeve, të cilat këtu nuk janë përshkruar, do të ishte i nevojshëm një marrje mendimi nga ana jonë. Në rast porosie plotësuese ose në lidhje me katalogun e ngjyrave, pigmentet mund të ndryshojnë minimalisht, prandaj dhe në kantiere duhet të bëni si fillim një mostër për krahasim. Të dhënat në lidhje me kohën e pritjes-veprimit janë percaktuar në kushtet e laboratorit (+20 °C/65 % Lagështirë/e mbetur) dhe sipas kushteve të kantierit mund të ndryshojnë.

Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda.